

LIGJ
Nr. 55/2024

**PËR FINANCIMIN E DETYRIMIT TË PRAPAMBETUR TË PAGESËS
SË PUNONJËSVE DHE ISH-PUNONJËSVE TË KOMBINATIT MEKANIK POLIÇAN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pagesa e detyrimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve, dhe të ish-punonjësve të ndërmarrjes “Kombinati Mekanik Poliçan”, për vitet 2017–2023, të financohet me fonde buxhetore.

Neni 2

Vlerat e detyrimeve, sipas listave të deklarimit në sistemin e tatimeve për pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore për punonjësit dhe ish-punonjësit e ndërmarrjes “Kombinati Mekanik Poliçan”, të njihen nga Ministria e Mbrojtjes si detyrime të prapambetura.

Neni 3

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2024 për Ministrinë e Mbrojtjes, në zërin “Shpenzime korrente”.

2. Ministria e Mbrojtjes miraton dhe përcjell për pagesë në degën e thesarit dokumentacionin justifikues, të përgatitur nga ndërmarrja “Kombinati Mekanik Poliçan”, si më poshtë:

- a) të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS, ku janë të punësuar;
- b) të dhënat identifikuese të përfituesit, si:
 - i. emri dhe mbiemri i përfituesit;
 - ii. numri personal i identifikimit të përfituesit;
 - iii. numri i llogarisë rrjedhëse të përfituesit dhe emri i bankës përkatëse;
 - iv. urdhërpagesa, deklarata e gjeneruar nga sistemi efileting.tatime.gov.al.

Neni 4

Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për ndjekjen e zbatimit të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.6.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 234, datë 26.6.2024, të Prestidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

